

VENDIM
Nr.631, datë 23.5.2008

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.335, DATË 2.9.1997 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE
DHE TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 3 të shtohen edhe:

- “- Zëdhënësi i Presidentit të Republikës;
- Ndihmësi i Presidentit të Republikës;
- Drejtori i Drejtorisë së Protokollit të Presidentit të Republikës;
- Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës;”.

2. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund shtohen edhe:

- “- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- Kryetari dhe zëvendëskryetari i Entit Rregullator të Telekomunikacionit;
- Kryetari dhe zëvendëskryetari i Entit Rregullator të Energjisë;
- Kryetari i Komisionit Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit

e përpunimit të ujërave të ndotura;

- Avokati i Prokurimeve;
- Përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve dhe punëdhënësve, në Këshillin Kombëtar të Punës;

- Inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Kryetarët e bashkive dhe të komunave;
- Drejtuesit e prokurorive të apelit;
- Fotografi i Presidentit të Republikës;
- Fotografi i Kryeministrit;
- Kameramani i Kryeministrit.”.

b) Emërtimi “Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha